## KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

## PROCES VERBAL

**Mbledhja jashtë rradhe e Këshillit Bashkiak Vau Dejës 17.07.2026**

**Data 17.07.2026 ora 14:00.**

**Mbledhja zhvillohet në sallen e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.**

**Rendi i dites:**

**1.**Projekt vendim për miratimin e planit të arsimit parauniversitar 2026-2029 në Bashkinë Vau Dejës.

**2.**Projekt vendim për miratimin e planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane,Bashkia Vau Dejës 2026-2031.

**3.**Projekt vendim për miratimin e planit të integritetit të Bashkisë Vau Dejës 2026-2029.

**4.**Projekt vendim përmiratimin e planit të barazisë gjinore 2026-2029 në Bashkinë Vau Dejës.

Grupe interesi nuk kishte prezent.Votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja jashtë rradhe e Këshillit Bashkiak Vau Dejës me kërkesë të Kryetarit Bashkisë me nr.5062/1 prot.datë 08.07.2026 u zhvillua me datë 17.07.2026 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija.Të pranishëm në sallë ishin 19 këshilltarë,(Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola, Elton Frashnaj,Majlinda Ndreca,Ornela Lleshi,Kastriot Shkjau,Edona Molla,Albina Livadhi,Mark Bisha,Roberto Trushi, Meliha Zyberaj,Arsen Mehmeti,Martin Mardoda,Mirela Vasija,Ermir Tahiri,Marin Dodaj,Rita Preçi,Sanije Salja), korum i mjaftueshëm dhe i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalen për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj -kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe kërkesen e Kryertarit Bashkisë.Pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës.Këshilltarët shprehen dakortësi.Hidhet në votim rendi i ditës:.**Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundër, zero vota abstenim.**Këshilltarët që votuan pro: (Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola, Elton Frashnaj,Majlinda Ndreca,Ornela Lleshi,Kastriot Shkjau,Edona Molla,Albina Livadhi,Mark Bisha,Roberto Trushi, Meliha Zyberaj,Arsen Mehmeti,Martin Mardoda,Mirela Vasija,Ermir Tahiri,Marin Dodaj,Rita Preçi,Sanije Salja).

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës**

Projekt vendim për miratimin e planit të arsimit parauniversitar 2026-2029 në Bashkinë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Melita Vjerdha-përgjegjëse e zyres arsimit,Bashkia Vau Dejës e cila relaton për këshilltarët se Plani Vendor për Arsimin Parauniversitar në Bashkinë Vau i Dejës është ndërtuar në përputhje të plotë me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026, duke siguruar që objektivat dhe masat e ndërmarra në nivel lokal të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të integruar të arsimit në nivel kombëtar. Plani do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Vau i Dejës dhe ai synon të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme të gjitha proceset që lidhen me arsimin parauniversitar.Kjo përputhje i jep Planit Vendor një qasje të integruar dhe garanton që çdo ndërhyrje në territorin e Bashkisë Vau i Dejës është pjesë e një vizioni më të gjerë kombëtar për një sistem arsimor më të fortë, më gjithëpërfshirës dhe më cilësor.

Z.Ervis Shimaj sqaron se për këtë projekt vendim është realizuar konsultim me publikun, dhe pyet këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.Këshilltarët u shprehen se janë njohur me materialin dhe se nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin.**Miratohet me 19 vota Pro,zero vota abstenim, zero vota kundër**.Këshilltarët që votuan Pro piken e parë të rendit të ditës (Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola, Elton Frashnaj,Majlinda Ndreca,Ornela Lleshi,Kastriot Shkjau,Edona Molla,Albina Livadhi,Mark Bisha,Roberto Trushi, Meliha Zyberaj,Arsen Mehmeti,Martin Mardoda,Mirela Vasija,Ermir Tahiri,Marin Dodaj,Rita Preçi,Sanije Salja).

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës**

Projekt vendim për miratimin e planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane,Bashkia Vau Dejës 2026-2031.

Z.Ervis Shimaj spjegon për këshilltarët se edhe për kete projekt vendim është realizuar konsultim publik dhe se të pranishmit kanë shprehur dakortësi për projekt vendimin, lidhur me projekt vendimin jeni të pajisur me materialin i cili konsiston se Dokumenti i Politikave Strategjike e rishikuar e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve zhvillohet mbi vizionin ose perceptimin e

konceptit "zero mbetje", që mbetjet të grumbullohen dhe trajtohen si lëndë të para dhe menaxhimi të bëhet në përputhje me konceptin e sistemeve të ekonomive qarkulluese, në shërbim të përdorimit me kriter dhe ruajtjes së burimeve të lëndëve të para.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët për të pyetur apo diskutuar lidhur me projekt vendimin.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime pasi ishin mjaft të qartë lidhur me projekt vendimin.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin.**Miratohet me 19 vota Pro,zero vota abstenim, zero vota kundër**.Këshilltarët që votuan Pro piken e dytë të rendit të ditës (Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola, Elton Frashnaj,Majlinda Ndreca,Ornela Lleshi,Kastriot Shkjau,Edona Molla,Albina Livadhi,Mark Bisha,Roberto Trushi, Meliha Zyberaj,Arsen Mehmeti,Martin Mardoda,Mirela Vasija,Ermir Tahiri,Marin Dodaj,Rita Preçi,Sanije Salja).

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës**

Projekt vendim për miratimin e planit të integritetit të Bashkisë Vau Dejës 2026-2029

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Xhuana Mardoda-drejtore e burimeve njrëzore,Bashkia Vau Dejes, e cila spjegon për këshilltarët se se Objektivat e këtij plani janë:

1. Pasurimin e kuadrit strategjik të institucionit të bashkisë.

2. Promovimin e vlerave të mirëqeverisjes

3. Rritjen e besimit të qytetarëve tek institucioni

4. Sigurimin e shërbimeve cilësore për komunitetin

5. Garantimi i një niveli sa më optimal të transparencës, llogaridhënies si edhe përfshiijes e pjesëmanjes së publikut në vendimarrjen e bashkisë.

6. Bashkepunimin sa më efektiv dhe të shpejtë ndërmjet zyrave, sektorëve dhe drejtorive.

Miratimi i planit te Integritetit, pasqyron përkushtimin e Bashkisë për të hedhur themelet e një sistemi më të gjerë, që menaxhon risqet që kërkeënojnë integritetin institucional në Bashkinë tonë. Synimet tona të shprehuar në këtë dokument, lidhen me krijimin e një mjedisi që nxit dhe promovon kulturën e integritetin në të gjitha fushat përgjegjësisë së institucionit, me fokus ofrimin e shërbimeve publike në mënyrë transparente, efikase dhe eficente.

Z.Ervis Shimaj spjegon për këshilltarët se edhe për kete projekt vendim është realizuar konsultim publik dhe se të pranishmit kanë shprehur dakortësi për projekt vendimin dhe fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime pasi ishin mjaft të qartë lidhur me projekt vendimin.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin.**Miratohet me 19 vota Pro,zero vota abstenim, zero vota kundër**.Këshilltarët që votuan Pro piken e tretë të rendit të ditës (Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola, Elton Frashnaj,Majlinda Ndreca,Ornela Lleshi,Kastriot Shkjau,Edona Molla,Albina Livadhi,Mark Bisha,Roberto Trushi, Meliha Zyberaj,Arsen Mehmeti,Martin Mardoda,Mirela Vasija,Ermir Tahiri,Marin Dodaj,Rita Preçi,Sanije Salja).

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës**

Projekt vendim përmiratimin e planit të barazisë gjinore 2026-2029 në Bashkinë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Çuka Babani- përgjegjëse e shërbimit social, Bashkia Vau Dejës e cila spjegon për këshilltarët se Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave kanë qenë prej kohësh objektiva të rëndësishëm. Për të avancuar më tej në përmbushjen e tyre në mënyrë sistematike dhe të qëndrueshme, duke integruar perspektivën gjinore në të gjitha politikat dhe programet vendore, kemi hartuar Planin Vendor për Barazinë Gjinore 2026-2029.Plani vendor për barazinë gjinore 2026 2029 bazohet në analizën e nevojave vendore dhe përvojës nga zbatimi i politikave të mëparshme, duke marrë në konsideratë praktikat më të mira dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore.

Në këtë plan janë parashikuar masa të qarta për promovimin e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në vendimmarrje, fuqizimin e tyre ekonomik dhe social, promovimin e barazisë gjinore midis grave dhe burrave, përmirësimin e aksesit të barabartë në shërbime për gratë e burrat, si dhe për adresimin e dhunës me bazë gjinore në komunitetin tonë.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar grupeve më të cënuara, si gratë në zonat rurale, vajzat e reja, gratë me aftësi të kufizuara apo ato që kanë përjetuar dhunë.Bashkia Vau Dejës mbetet e përkushtuar për të ndërtuar një shoqëri të drejtë, ku askush nuk mbetet pas dhe ku të drejtat e çdo individi respektohen e garantohen.

Z.Ervis Shimaj spjegon për këshilltarët se edhe për kete projekt vendim është realizuar konsultim publik dhe se të pranishmit kanë shprehur dakortësi për projekt vendimin dhe fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime pasi ishin mjaft të qartë lidhur me projekt vendimin.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin.**Miratohet me 19 vota Pro,zero vota abstenim, zero vota kundër**.Këshilltarët që votuan Pro piken e katërt të rendit të ditës (Ervis Shimaj, Frano Prenga,Franga Kola, Elton Frashnaj,Majlinda Ndreca,Ornela Lleshi,Kastriot Shkjau,Edona Molla,Albina Livadhi,Mark Bisha,Roberto Trushi, Meliha Zyberaj,Arsen Mehmeti,Martin Mardoda,Mirela Vasija,Ermir Tahiri,Marin Dodaj,Rita Preçi,Sanije Salja).

*Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail: info@vaudejes.gov.al*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbledhja jasa jashtë rradhe e datës 17.07.2026, deklarohet e mbyllur nga Kryetari Këshillit.

**Mbajtësi i Protokollit**

**Sekretari Këshillit**

**Ardian ÇELEPIJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA VAU I DEJËS

Këshilltarët:

1. Enis Shima
2. Frano Preugo
3. Tringa Kolo
4. Xavier Radaj
5. Melike Ejbera
6. Majlinda Nanore
7. Ornela Lleshi
8. Elton Frothaj
9. Arsen Mehmeti
10. Kastriot Shkjau
11. Rita Breçi
12. Ermir Tahiri
13. Mirela Vasija
14. Alina Livadhi
15. Edona Molla
16. Martin Marolodo
17. Sanije Saljo
18. Mark Bisk
19. Roberto Troshi
20.
21.
22.
23.
24.
25.
26.
27.
28.
29.
30.
31.

Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail: info@vaudejes.gov.al